



Datë: 06.10.2025
Numër Protokolli: 6780/2025

A.nr.1403/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyll Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1403/2025, të datës 17.07.2025, të parashtruar nga ankuesi B.B, të cilin më autorizim e përfaqëson Endrit Rustemi nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Ministra e Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datën 06.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.1403/2025, të datës 17.07.2025, të parashtruar nga ankuesi B.B.
- II.** Pala ankuese udhëzohet mbi të drejtën e inicimit të kontestit juridik-civil pranë gjykatës kompetente.

A r s y e t i m

Ankuesi B.B (tutje referuar vetëm ankuesi), më datë 17.07.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të organit të punësimit lidhur me kërkesën e parashtruar më datë 29.04.2025, e përsëritur më datë 08.06.2025, përkitazi më mos kompensimin e shtesave për kushte të tregut të punës për profesionet nga programet studimore të financuara ose bashkë financuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, në kohëzgjatje prej pesë muajve.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të provave materiale të pashtuara nga palët në procedurë vlerëson së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovë **nuk është kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën e lakuesit të datës 17.07.2025, **sepse:**

Ankuesi sipas Akt Emërimit AE.Nr.38/2021 të datës 08.04.2021, ka qenë i punësuar në pozitën *Analist i Lartë i TI për Sisteme, Departamente për Menaxhimin e Shërbimeve të Teknologjisë Informative* në kuadër të MFPT-së, dhe së i njëjti në vitin 2023, ka qenë edhe përfitues i shtesave për kushte të tregut të punës për profesionet nga programet studimore të financuara ose bashkëfinancuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës,, ndërsa, nga data 01.06.2024 ankuesi është liruar nga shërbimi civil si pasojë e kërkesës për dorëheqje nga shërbimi civil (e parashtruar më datë 25.03.2024).

Tutje, ankuesi më datë 29.04.2025 përmes kërkesës me numër protokolli 1299/2025, i është drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të MFPT-së me të kërkesë për kompensim të shtesës mujore si përfitues i programit Young Cell Scheme sipas Rregullores (MFPT) Nr. 02/2023 për Shtesën për Kushte të Tregut të Punës, për një periudhë prej pesë (5) muaj, kërkesë të cilën e kishte përsëritur edhe me datë 18.06.2025.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se edhe përkundër faktit që e drejta për kompensim si përfitues i Programit të Young Cell Scheme i takon sipas rregullatave ligjore, kërkesat e vazhdueshme nuk janë adresuar dhe kompensimi për pesë (5) muaj nuk është bërë. Kërkon që ankesa të aprovohet, të konstatohet se MFPT ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore për mos kompensim të shtesës mbi pagën bazë prej pesë (5) muaj dhe të urdhëroj MFPT që të ndërmarr veprimet e nevojshme për kompensim të shtesës për kushte të tregut të punës për profesionet nga programet studimore të financuara ose bashkë financuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës për periudhën pesë mujore.

Rrjedhimisht, në kuptim të kompetencës materiale të Këshillit për vendosje lidhur me këtë çështje juridike-administrative, Kolegji fillimisht thekson faktin se ankuesi deri me datë 01.06.2024 kishte statusin e nëpunësi civil, gjegjësisht ankuesi më datë 25.03.2024 ka paraqitur kërkesë të organi i punësimit për dorëheqjen nga pozita që ka ushtruar me efekt nga data 01.06.2024, ndërsa, më Vendimin Nr.18/2024, të datës 10.05.2024 të Udhëheqësit të Divizionit të Burimeve Njerëzore të MFPT-së, ankuesi është liruar nga shërbimi civil me fillim nga data 01.06.2024, pra, nga kjo datë ankuesi nga ka humbur statusin e nëpunësit civil.

Andaj, nisur nga përcaktimi ligjor sipas nenit 6, paragrafin 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, se Këshilli ka juridiksion që të shqyrtoj vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, dhe duke qenë se ankuesi më rastin e parashtrimit të kërkesës më datë 29.04.2025, nuk ka pas statusin e nëpunësit aktiv civil, atëherë, mbi ekzistimin e kësaj rrethane ligjore Kolegji konstaton se Këshilli nuk është kompetent për të shqyrtuar dhe vendosur lidhur me ankesën e ankuesit A.nr. 1403/2025, të datës 17.07.2025.

Si rrjedhojë, referuar pretendimeve ankimore të parashtruara si në ankesë, rezulton se në rastin konkret kemi të bëjmë më raport juridiko-civil, ashtu që, Kolegji i Këshillit lidhur më të drejtën e ankuesit në mjete juridike si e drejtë kushtetuese garantuar më Kushtetutë dhe Konventën Evropiane për të Drejta e Njeriut (neni 13), udhëzon palën ankuese që drejtën e tij materiale të pretenduar si në ankesë ta realizoj në kontest civil në pajtim me dispozitat e Ligjit përkatës për Procedurën Kontestimore. Gjegjësisht, lënda nuk mund të bartet tek gjykata kompetente ngase në këtë fazë mungon padia si kusht kryesor për fillimin e një procesi gjyqësor.

Thënë si me sipër e në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.1403/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit Endrit Rrustemi;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në MFPT; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.